



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 858 Prot.

Tiranë, më 13. 06. 2018

V E N D I M

Nr. 138, Datë 13. 06. 2018

Mbështetur në ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa Nr. 8, datë 15.01.2018, e shtetasit E. N., kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër, në të cilën pretendon diskriminim *për shkak të bindjeve politike¹ dhe gjendjes shëndetësore.*

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

Sipas pretendimeve të paraqitura në ankesë, E. N. sqaron se, më datë 20.10.2017, me anë të një shkrese zyrtare, organizata e Partisë Socialiste, Rajoni 5, Shkodër, ka vënë në dijeni Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Shkodër, mbi përfshirjen e ankuesit në fushatë elektorale si koordinator të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim. Me vendim nr. 704, datë 25.10.2017, E. N. bëhet me dije nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për ndërprerjen e delegimit të kompetencave si Drejtor i Shërbimit të Tatimpaguesve dhe rikthimin e tij në pozicionin e mëparshëm të Specialistit në Sektorin e Asistencës dhe Shërbimit të Tatimpaguesve, të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër. Sipas ankuesit, ndërprerja e delegimit të kompetencave si Drejtor i Shërbimit të Tatimpaguesve, është bërë pa një arsyetim konkret nga ana e punëdhënësit. Pas emërimit në pozicionin e Specialistit në Sektorin e Asistencës dhe Shërbimit të Tatimpaguesve, pretendohet se ndaj ankuesit ka vijuar të ushtohet presion dhe kontrole të herë pas hershme.

¹ Mbështetur në Kartën e Antarësisë Nr. 36554, datë 20 Tetor 2016, të paraqitur pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, E. N. është anëtarë i Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim.

Më datë 10.01.2018, nga ana e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, ndaj ankuesit ka nisur ecuria disiplinore, me pretendimin se në periudhën Nëntor-Dhjetor, nuk ka bërë më dije punëdhënësin për mosprezencën e tij në punë prej 11 (njëmbëdhjetë) ditësh. Sipas ankuesit, për këtë periudhë kohore, ai ka qënë me raport mjeksor të lëshuar nga Poliklinika Shkodër, për të cilin ka kërkuar ta depozitojë pranë Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër, por nuk është pranuar prej tyre.

Përsa më sipër, ankuesi pretendon se me veprimet dhe mosveprimet e sipërcituara, është trajtuar në mënyrë diskriminuese, nga ana e drejtuesve të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër, për shkak të bindjeve politike dhe gjendjes shëndetësore.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32, pika 2 dhe 33, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Pas analizimit paraprak të ankesës, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

1. Mbështetur në nenin 33, pika 7 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, pas verifikimit paraprak të ankesës, Komisioneri me anë të shkresës nr. 94/1 prot., datë 19.01.2018, i kërkoi E. N., informacion mbi pretendimet e ngritura në ankesë.
 - Me anë të shkresës protokolluar pranë KMD-së me Nr. 94/2 prot., datë 24.01.2018, E. N. vuri në dispozicion informacionin e kërkuar për të vijuar shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës.
2. Në vijim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me anë të shkresës Nr. 94/3 prot., datë 31.01.2018, kërkoi informacion lidhur me pretendimet e subjektit ankues nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër.
 - Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, me anë të shkresës² Nr. 2324/1 prot., datë 12.02.2018, sqaroi se: *“Drejtori i Përgjithshëm në cilësinë e titullarit të institucionit, ka detyrim ligjor, mirëfunksionimin e administratës, mbarëvajtjen e punës, sigurimin e realizimit të detyrave funksionale dhe vijueshmërisë së*

² Protokolluar pranë KMD-së me nr. 94/4 prot., datë 15.02.2018

përmbushjes së tyre, për këtë qëllim ka të drejtën ligjore të delegimit të kompetencave nëpunësve aktual, duke respektuar dispozitat ligjore, për shkak të vakancës së hershme të një pozicioni pune, fluksit të madh të punës, etj. Me vendimin nr. 2022, datë 20.12.2016, Drejtori i Përgjithshëm, ka vendosur delegimin e kompetencave të Drejtorit të Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve, në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Shkodër, E. N., bazuar në propozimin e bërë nga Drejtori i Drejtorisë Rajonale Shkodër, të cilat i janë ndërprerë me vendim nr. 704, datë 25.10.2017. Për këtë vendim, për delegim kompetencash, nuk pa patur ndonjë pretendim në momentin e zbardhjes së tij nga ana e E. N., për të kërkuar arsyet e marrjes së tij. Përzgjedhja e nëpunësve, të cilëve u ngarkohen detyra me vendim të Titullarit të Institucionit, për ushtrim të përkohshëm të funksioneve të caktuara, është diskrecion i eprorit direkt, kryesisht e Drejtorit të Drejtorisë Rajonale, i cili kryen propozimet përkatëse, duke mbikqyrur dhe vlerësuar në mënyrë konstante performancën e secilit punonjës. Kjo praktikë pune, është ndjekur nga administrata tatimore për vetë natyrën, specifikën e llojeve të veprimtarisë së strukturave dhe garantimin e vazhdimësisë së përmbushjes së detyrave funksionale. Organi delegues, në përfundim të shkakut apo qëllimit të delegimit, ka të drejtën e ndërprerjes së tij, i cili finalizohet me akt administrativ individual/vendim, i cili i është vënë në dispozicion E. N., në të njëjtën mënyrë si akti i delegimit, vendimi nr. 2022, datë 20.12.2016. Duke qënë se plotësimi i vendeve vakante sipas Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, i pamundur gjatë 2017, nëpunës të caktuar, janë propozuar nga eprorët e tyre, për të kryer disa detyra shtesë, në kushtet e mungesës së stafit. Delegimi dhe ndërprerja e delegimit të kompetencave, nuk cënon asnjë të drejtë të nëpunësve civil, emëruar në pozicion të rregullt, si specialist, etj. Gjithashtu ju informojmë se, për periudhën e kërkuar nga ju, Tetor 2017-Janar 2018, në Drejtorinë Rajonale Shkodër, nuk janë emëruar punonjës të rinj, por kemi 3 (tre) raste, të rikthimit në pozicionin e mëparshëm të punës, të gjyq-fituesve, të cilët kanë fituar të drejtën, me vendim gjyqësor të formës së prerë.”

- Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër, me anë të shkresës³ nr. 1097/1 prot., datë 14.02.2018, sqaroi se: “DRT Shkodër gjykon të sqarojë, se referuar gjendjes së faktit E. N. nuk është paraqitur në punë për të kryer detyrën funksionale pranë DRT-së Shkodër nga data 30.11.2017 deri më datë 13.12.2017, ai nuk ka njoftuar apo komunikuar në asnjë lloj forme lidhur me arsyet e mosparaqitjes në punë. Duke qënë në kushtet e mosparaqitjes së tij në punë, eprori direkt i tij pranë DRT Shkodër, ka kërkuar sqarime me anë të e-mail-it, datë 14.12.2017 dhe E. N. nuk ka kthyer përgjigje. Me datën 14.12.2017 është paraqitur në punë dhe nuk ka bërë prezent apo komunikuar asnjë dokumentacion justifikues konform rregullave ligjore, lidhur me mosparaqitjen e tij

³ Protokolluar pranë KMD-së me nr. 267 prot., datë 19.02.2018

në punë, megjithëse i është kërkuar qëndrim dhe me email datë 18.12.2017 (bashkëngjitur korrespondenca e mbajtur.)”

3. Mbështetur në Urdhërin nr. 43, datë 23.02.2018 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi “*Për kryerjen e inspektimit pranë Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër, me qëllim marrjen e informacionit, lidhur me ankesën e E. N.*”, më datë 06.03.2018, inspektorët e KMD-së u paraqitën pranë Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër, për të kryer verifikimet përkatëse mbi çështjen në fjalë.

Gjatë inspektimit pranë Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër, u mor takim me Drejtoren e Funksioneve Mbështetëse të këtij institucioni, M. A., e cila informoi lidhur me çështjen se: “*Fillimisht duke qënë se pozicioni i Drejtorit dhe Përgjegjësit të Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve ishin vakant, nga ana DRT Shkodër u propozua t’i delegohen këto kompetenca E. N. për një afat të pacaktuar. Pas procedurës së konkurimit nga DAP, në pozicionin e Përgjegjësit të Sektorit të Asistencës dhe Shërbimit të Tatimpaguesve u emërua me lëvizje paralele S. B.. Në këto kushte, u ndërpre delegimi i kompetencave të E. N. dhe kjo detyrë iu delegua S. B., duke qënë se mbante edhe pozicionin e përgjegjëses së së sektorit. Aktualisht për shkak të mosprezencës në punë në mënyrë të vazhdueshme Komisioni Disiplinor në DPT mori vendimin për largimin nga puna të E. N. Edhe pas ndërprerjes së delegimit të detyrës së Drejtorit edhe rikthimit në pozicionin e specialistit, E. N. vijojë të mosparaqitej në punë.”*

Lidhur me largimin nga puna për shkak të një shkresë ku citon bindjet politike të ankuesit, M. A. sqaroi se: “*Nga informacioni që kam në Protokollin e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër nuk rezulton të ketë ardhur shkresa e pretenduar nga E. N.*”

Gjithashtu nga kqyrja që iu bë librit të protokollit të DRT-së Shkodër nga data 15.09.2017 deri më datë 29.10.2017, nuk rezultoi që pranë këtij institucioni të ishte depozituar shkresa për të cilën ankuesi ngre pretendimet në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

4. Në vijim të trajtimit të ankesës së E. N., më datë 05.04.2018, pranë Zyrës së KMD-së, u realizua seanca dëgjimore, ku morën pjesë: E. P., përfaqësuese e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve; M. A., përfaqësuese e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër dhe B. K., përfaqësues me prokurë i ankuesit.

Fillimisht nga ana e B. K., u sqarua ndër të tjera se: “*...Arsyeja e ndërprerjes së delegimit të detyrës së Drejtorit të Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve, është vetëm ajo politike, e cila lidhet me përmbajtjen e një shkresë të dërguar nga shtetasi M. H., si përfaqësues i Organizatës së Partisë*

Socialiste Shkodër. Pas verifikimeve të kryera, shtetasi M. H. është një person që nuk ekziston në Rregjistrin Themeltar të Gjendjes Civile. Gjithashtu, kemi kërkuar nga DPT dhe DRT Shkodër, kopje të kësaj shkrese, po nuk na është vënë asnjëherë në dispozicion. Aktualisht E. N. është larguar nga puna. Ndërprerja e delegimit të detyrave të drejtorit është bërë për arsye politike. Tashmë është larguar edhe detyra e Specialistit.”

Lidhur me mosprezencën e E. N. në punë për periudhat e pretenduara, B. K. u shpreh se: *“Raporti i parë për paaftësi të përkohshme në punë, është pranuar nga ana e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër, ndërsa Raporti i dytë mjekësor nuk është marrë në konsideratë. Të dy raportet mjekësore janë dorëzuar në Zyrën e Financës së DRT-së Shkodër dhe i dyti nuk është marrë në konsideratë. Kjo procedurë ndiqet për të gjithë.”*

Në përgjigje të parashtrimeve të bëra nga B. K., M. A. u shpreh se: *“Sipas procedurës kur një punonjës është me raport, njofton eprorin direkt për pamundësinë e prezencës në punë. E. N. nuk ka njoftuar për mosprezencën në punë. Kam kërkuar tek eprori direkt i tij, justifikimin për mosprezencën në punë për periudhën 16.11.2017-30.11.2017 dhe mora dijeni që kishte dorëzuar raportin mjekësor. Ndërsa raporti i dytë, i datës 01.12.2017, nuk është dorëzuar si në rastin e parë. Më datë 15.12.2017, është paraqitur në punë dhe i është kërkuar të dorëzojë raportin mjekësor dhe eprori direkt më njoftoi se E. N. nuk dispononte një të tillë për periudhën 30.11.2017-15.12.2017.”*

Lidhur me këtë B. K., sqaroi se: *“Më datë 30.10.2017, ankuesi ka marrë një urdhër pune i cili e ngarkonte me detyrë inspektimi për periudhën 30.10.2017-31.12.2017. Gjatë kësaj periudhe E. N. nuk është paraqitur asnjë ditë në DRT Shkodër, para datës 05.01.2018.”*

Në vijim B. K. kërkoi nga përfaqësuesit e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve informacion mbi procedurën që ndiqet për dorëzimin e raporteve mjekësore për paaftësi të përkohshme në punë.

Në përgjigje përse më lart, E. P. sqaroi se: *“Rregullorja e DPT-së dhe DRT Shkodër përcakton se specialisti duhet të raportojë çdo ditë tek eprori direkt. Nga B. K. duhet të sqarohet nëse ka dalë në punë apo ka qënë me raport. A ka ndonjë provë për të vertetuar se kur është paraqitur raporti mjekësor pranë DRT-së Shkodër. E. N. nuk ka njoftuar për asnjë moment mungesën në punë. Çdo ditë specialistët marrin takim me eprorin direkt. Në staf-tatime për shkak të fluksit të punës nga muaji Shtator 2017 e në vijim, nëpërmjet emailit janë njoftuar punonjësit se orari zyrtar do të shtyhej deri në orën 18:00.”*

Lidhur me këtë M. A. sqaroi se: *“Në orën 08:00, çdo punonjës i DRT-së Shkodër del në punë dhe eprori direkt mban listë-prezencën, ku edhe për rastin konkret është mbajtur një e tillë.”*

Lidhur me ndërprerjen e delegimit të kompetencave të E. N., E. P. u shpreh se: *“Është e drejta e Drejtorit të DPT-së të delegojë dhe të ndërpresë detyrat brenda strukturës së DPT-së. Duke qënë se DAP nuk kishte hapur procedurat e konkurimit për Drejtorin dhe Përgjegjësin e Shërbimit të*

Tatimpaguesve, është bërë delegimi i kompetencave E. N. Pas emërimit të Përgjegjës të Sektorit të Shërbimit të Tatimpaguesve, E. N. i është bërë ndërprerja e delegimit të kompetencave, si dhe arsyeja e rikthimit në pozicionin e Specialistit ishte shtimi i fluksit të punës. Pas rikthimit në detyrën e specialistit, E. N. ka vijuar më tej me mungesat në punë dhe për këtë arsye është larguar nga puna. Gjithashtu, më datë 17.01.2018 dhe 07.02.2018, E. N. nuk është paraqitur në Komisionin e Disiplinës së Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për shqyrtimin e shkeljeve disiplinore në punë.”

Sipas M. A., pas ndërprerjes së delegimit të kompetencave të Drejtorit të Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve, ky pozicion nuk i është deleguar ndonjë punonjësi tjetër deri në momentin që është emëruar Përgjegjësja e Sektorit të Tatimpaguesve.

Në përfundim B. K., sqaroi se: *“Pretendimi i diskriminimit lidhet vetëm me ndërprerjen e delegimit të detyrave të drejtorit për E. N., situatë për të cilën ka paraqitur ankesë pranë KMD-së, ndërsa për pjesën tjetër të marrëdhënieve të punës nuk kemi pretendime.”*

Në mbështetje të pretendimeve të sipërcituara, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, vuri në dispozicion, nëpërmjet shkresës Nr. 29009/1 prot., datë 09.02.2018, informacionin e kërkuar nga KMD.

5. Pas informacionit të administruar gjatë seancës dëgjimore të datës 05.04.2018, nëpërmjet shkresës Nr. 555 prot., datë 23.04.2018, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua sërish Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër, duke i kërkuar të vërë në dispozicion:

- Informacion rreth procedurës së miratuar, për njoftimin e punëdhënësit në rastet e mosprezencës në punë për arsye shëndetësore.
- Kopje të Rregullores së Brendshme të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër.
- Informacion rreth përmbajtjes së shkresës së dërguar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve me Nr. Reference të Postës Shqiptare: RR753691409AL.
- Informacion rreth përmbajtjes së shkresës së dërguar pranë Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër me Nr. Reference të Postës Shqiptare: RR753691390AL.

Në përgjigje të kërkesave të sipërcituara, lidhur me shkresën e dërguar me Nr. Reference të Postës Shqiptare: RR753691390AL, Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër, informoi⁴ duke sqaruar se: *“Shkresat e hyra rregjistrohen në rregjistrat përkatës me numër protokollit duke ndjekur numrin progresiv, pajisen me kartelë shoqëruese, kalojnë për firmë tek Drejtori i Drejtorisë Rajonale, i cili i vendos shënimin për delegimin e shkresës, më pas merren nga protokollit dhe me libër të veçantë u dorëzohen kundrejt firmës drejtorëve të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve. DRT Shkodër nuk ka informacion mbi përmbajtjen e shkresës, përderisa ajo nuk ka një numër protokollit që të verifikohet më tej”*.

Në përgjigje të kërkesave të KMD-së, si dhe lidhur me shkresën e dërguar me Nr. Reference të Postës Shqiptare: RR753691409AL, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, informoi⁵ duke sqaruar se, përzgjedhja e nëpunësve, për ushtrim të përkohshëm të funksioneve të caktuara, është diskrecion i eprorit direkt, i cili kryen propozimet përkatëse, duke mbikqyrur dhe vlerësuar në mënyrë konstante performancën e silit punonjës. Duke qënë se plotësimi i vendeve vakante, ka qënë i pamundur gjatë vitit 2017, nëpunës të caktuar, janë propozuar nga eprorët e tyre, për të kryer disa detyra shtesë, në kushtet e mungesës së stafit. Një procedurë e tillë është ndjekur edhe për E. N.

Lidhur me shkresën e dërguar me Nr. Reference të Postës Shqiptare: RR753691409AL, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, informoi se: *“Siç kemi shpjeguar dhe provuar (faqe të rregjistrit të librit të protokollit për hyrjen e shkresave hyrëse) edhe në seancën dëgjimore, kjo shkresë nuk është rregjistruar pranë Administratës Tatimore, si dhe pala ankuese ngre pretendim verbal, në asnjë moment nuk vërtetoi ekzistencën e saj, si dhe pala nuk paraqiti shkresën e sipërcituar, por vetëm nëpërmjet aparatit telefonik lexoi përmbajtjen e një shkrese.”*

Në përfundim, përsa i përket procedurës së njoftimit të punëdhënësit në rastet e mosprezencës në punë, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, informoi se: *“Në zbatim të dispozitave ligjore, neni 57, pika 2/ç, 3/b, 4/a të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, çdo nëpunës/punonjës, ka detyrim ligjor për njoftim të mungesës së tij në pozicionin e punës, sipas ditëve të planifikuara. Pala ankuese, ngre pretendimin se, ka dorëzuar, jo personalisht, raportin mjeko-ligjor pranë DRT Shkodër, i cili nuk është pranuar nga nëpunësi përgjegjës. Pra, edhe ky pretendim nuk argumentohet dhe provohet me prova dhe fakte, për tu marrë në analizë. Ndërsa, nga ana jonë, u sqarua dhe u provua (e-mail i dërguar nga nëpunësi përgjegjës, me të cilin është kërkuar dorëzimi i raportit dhe për të cilin nuk ka përgjigje), fakti se, E. N. nuk ka njoftuar dhe nuk ka depozituar raport mjeko-ligjor për ditët e mosprezencës.*

⁴ Me anë të shkresës Nr. 3761/1, datë 04.05.2018, protokolluar pranë KMD-së me Nr. 555/2 prot., datë 04.05.2018.

⁵ Me anë të shkresës Nr. 8496/1, datë 02.05.2018, protokolluar pranë KMD-së me Nr. 555/1 prot., datë 07.05.2018.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

Mbështetur në provat e administruara nga të dy palët, rezultoi se:

Në përfundim të procedurave të shqyrtimit të ankesës dhe bazuar në dokumentacionin e administruar, Komisioneri vëren se:

Nga verifikimi i informacioneve dhe dokumentacionit të administruar në dosje rezulton se, ankuesi është emëruar pranë Drejtorisë Rajonale të Tatimeve, në pozicionin e Specialistit të Sektorit të Edukimit dhe Marrëdhënëve me Publikun, më datë 20.01.2014. Më datë 01.12.2016, për shkak të ristrukturimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, nga pozicioni i punës që mbante, transferohet me detyrë Specialist në Sektorin e Asistencës dhe Shërbimit të Tatimpaguesve, në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Shkodër. Duke qënë se, në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Shkodër, pozicioni i Drejtorit dhe Përgjegjës të Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve ishin vakant, me propozim të DRT-së Shkodër, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, me Vendim Nr. 2022, datë 20.12.2016, i ka deleguar kompetencat e Drejtorit të Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve, për një afat të pacaktuar E. N. Me vendim Nr. 704, datë 25.10.2017, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, sërish me propozim të DRT-së Shkodër, ka vendosur ndërprerjen e delegimit të kompetencave E. N. dhe me vendim Nr. 706, datë 25.10.2017, delegimin e tyre S. B., e cila mbante detyrën e Përgjegjës së Sektorit të Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve.

Neni 28, pika 2 e Ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës Së Shqipërisë”, parashikon se: “*Organet publike kompetente mund të delegojnë kompetencat e dhëna me ligj ose me akte nënligjore tek organet e tyre vartëse*” dhe Neni 29, pika 1, parashikon se: “*Kur ligji e lejon, delegimi i kompetencave bëhet në çdo rast me vendim të organit delegues për organet në varësi të tij dhe me vendim ose me marrëveshje në ato raste kur organi i deleguar nuk është në varësi të organit delegues.*”

Përsa më lart, në mungesë të Drejtorit dhe Përgjegjës të Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve, në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Shkodër dhe për nevoja të punës, me propozim të DRT-së Shkodër, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve i ka deleguar kompetencat e Drejtorit të Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve, për një afat të pacaktuar E. N. Pas emërimit të S. B., në pozicionin e Përgjegjës së Sektorit të Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, ka vendosur ndërprerjen e delegimit të kompetencave E. N. dhe delegimin e tyre S. B.

Në këto kushte, duke qënë se tashmë ishte emëruar një punonjës i nivelit më të lartë në Drejtorinë e Shërbimit të Tatimpaguesve dhe në kushtet kur E. N. ka qënë punonjës i kategorisë ekzekutive, si dhe referuar kompetencave të punëdhënësit, ankuesi është rikthyer në detyrën e mëparshme, në pozicionin e Specialistit të Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve.

Pas rikthimit në detyrën e Specialistit të Sektorit të Asistencës dhe Shërbimit të Tatimpaguesve, referuar listëprezencës së DRT-së Shkodër, nga data 16 deri më datë 30 nëntor 2017, ankuesi nuk është paraqitur në punë dhe me anë të Raportit Mjekësor Nr. 4522 rregj., datë 16.11.2017, ka bërë me dije punëdhënësin për mosprezencën në punë për shkak të paaftësisë së përkohshme. Refruar Listëprezencës së Punonjësve të DRT –së Shkodër dhe informacionit të administruar, për periudhën 1-14 Dhjetor 2017, vihet re se ankuesi nuk ka qënë prezent në punë. Për këtë nga ana e punëdhënësit, në datat 14.12.2017 dhe 18.12.2017, i është kërkuar me e-mail të paraqesë dokumentacionin justifikues lidhur me mosprezencën në pozicionin e punës. Së fundmi, më datë 14.12.2017, Drejtori i DRT-së Shkodër, ka kërkuar nga Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse të kontaktohet sërish E. N. për të vënë në dispozicion dokumentacionin përkatës për justifikimin e mosprezencës në punë, në rast të mungesës së këtij dokumentacioni, ndaj tij të nis ecuria disiplinore. Në kushtet që, E. N. nuk ka informuar punëdhënësin, nga ana e DRT-së Shkodër, me anë të shkresës Nr. 12826 prot., datë 18.12.2017, është vënë në dijeni Komisioni Disiplinor i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për marrjen e masave disiplinore ndaj tij, për shkak se nuk ka justifikuar mosprezencën në punë dhe ka sjellë pasojë në mospërbushjen e detyrave të ngarkuara.

Me anë të shkresës Nr. 29009/1 prot., datë 10.01.2018, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, ka vënë në dijeni E. N. për fillimin e ecurisë disiplinore, si dhe e ka njoftuar lidhur me realizimin e mbledhjes së Komisionit Disiplinor që do të mbahej më datë 17.01.2018, në të cilën mund të parashtronte pretendimet e tij. Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, me anë të shkresës⁶ datë 17.01.2018, E. N. ka informuar Komisionin Disiplinor se ndaj tij po ushtrohet presion dhe diskriminim për shkak të bindjeve politike dhe ecuria disiplinore e nisur nuk kishte të bënte me anën profesionale apo performancën në punë.

Referuar provave dhe fakteve të administruara, ankuesi ka dorëzuar pranë KMD-së në cilësinë e provës, një kopje të raportit mjekësor Nr. 1306 rregj., datë 01.12.2017, ku cilësohet se i jepej pushim nga data 30.11.2017, deri më datë 15.12.2017. Me anë të tij, ankuesi faktori paaftësinë e përkohshme në punë për periudhën 11 (njëmbëdhjetë) ditore, për të cilën i ka nisur ecuria disiplinore, por nga provat dhe informacioni i administruar nuk rezulton që të jetë dorëzuar pranë punëdhënësit, apo ky i fundit të ishte vënë në dijeni të tij.

⁶ Protokolluar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve me Nr. 1034 prot., datë 17.01.2018

Në vijim, Komisioni Disiplinor konstatoi se mungesat e pajustificuara në pozicionin e punës dhe mos realizimi i detyrave në kuadër të Planit Anti Informalitet, kanë sjellë pasoja shumë të rënda në përmbushjen e detyrave të institucionit. Gjithashtu, Komisioni ka konstatuar se pavarësisht se ka marrë dijeni edhe për procedurën e ecurisë disiplinore, E. N. ka vijuar të mos paraqitet në punë dhe nga informacionet e kolegëve është larguar jashtë vendit, duke mos dorëzuar detyrën. Në përfundim të arsyetimit Komisioni Disiplinor ka vendosur: “*Marrjen e masës disiplinore largim nga shërbimi civil për nëpunësin E. N.*”.

Ligji Nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, në Nenin 57 të tij, parashikon se:

“*1. Nëpunësi civil është përgjegjës për shkeljen me faj të detyrimeve të nëpunësit civil sipas ligjit. Shkeljet në shërbimin civil ndahen në:*

a) shkelje shumë të rënda;

b) shkelje të rënda;

c) shkelje të lehta.

2. Janë shkelje shumë të rënda:

a) mospërmbushja e rëndë e detyrave;

b) mosrespektimi i përsëritur i afateve të caktuara në përmbushjen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasoja shumë të rënda;

c) moszbatimi haptazi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale;

ç) braktisja e punës ose mungesa e pajustificuar dhe e vijueshme për 7 ditë pune ose më shumë, kur mungesa ka sjellë pasoja shumë të rënda në përmbushjen e detyrave të institucionit;

d) përfitimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë i dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, të cilat jepen për shkak të detyrës.

3. Janë shkelje të rënda:

a) mospërmbushja e detyrave;

b) braktisja e punës ose mungesa e pajustificuar dhe e vijueshme për 3 ditë pune apo më shumë, kur mungesa ka sjellë pasoja të rënda;”.

Nenet 58 dhe 59, të ligjit të sipërcituar parashikojnë llojet e masave disiplinore që mund të zbatohen ndaj nëpunësve civil, ku një ndër të cilat është dhe largimi nga shërbimi civil, si dhe kompetencën e komisionit disiplinor për të dhënë masën disiplinore për largim nga shërbimi civil.

Përsa më lart dhe pasi është analizuar situata e ndodhur, nga ana e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, janë ndjekur hapat e parashikuara në legjislacion për largimin nga shërbimi civil për shkak të shkeljeve të rënda disiplinore të kryera nga ana e E. N.

Neni 7, pika 1, e ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi” parashikon se: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.

Në nenin 12/1/b) të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, parashikohet se: “Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve”.

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Në përfundim, referuar provave dhe fakteve të administruara, Komisioneri konstaton se:

- Përsa i përket ndërprerjes së delegimit të kompetencave të Drejtorit të Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve, është në cilësinë e titullarit të institucionit, i cili për shkak të mirëfunksionimit të administratës, mbarëvajtjes së punës dhe vijueshmërisë së përmbushjes së detyrave, të bëjë delegimin e kompetencave nëpunësve, duke respektuar dispozitat ligjore, për shkak të vakancave të një pozicioni pune.
- Nuk provohet pretendimi i ankuesit se ka paraqitur raportin për paaftësi të përkohshme në punë për periudhën 30.11.2017, deri më datë 15.12.2017 tek punëdhënësi. Pavarësisht se ai është njoftuar nëpërmjet postës zyrtare elektronike (e-mailit) të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër, nuk ka ngritur për asnjë moment pretendime ndaj drejtuesve, për mospranimin e raportit mjekësor të sipërcituar, deri në momentin që është njoftuar për fillimin e ecurisë disiplinore. Megjithëse ndaj tij ka nisur procedura disiplinore, E. N. ka vijuar të mosparaqitet në punë.

Në analizë të provave dhe informacionit të sipërcituar, Komisioneri evidenton se E. N. nuk është ekspozuar ndaj një trajtimi të pabarabartë dhe të disfavorshëm, në raport me punonjës të tjerë, lidhur në procedurat e ndjekura përndërprerjen e delegimit të kompetencave të Drejtorit të Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve.

Mbështetur në nenin⁷ 2 të ligjit nr. 10221, datë 02.04.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj.

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Për të vërtetuar se faktin se ankuesi është ekspozuar ndaj një sjelljeje diskriminuese nga ana e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, duhet të ekzistojë një lidhje shkakësore ndërmjet shkakut të mbrojtur nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”⁸ dhe trajtimin të pafavorshëm të ankueses.

Nga dokumentet e administruara gjatë trajtimit të ankesës dhe shpjegimet e dhëna nga palët, konstatohet se zarfi i dërguar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve me Nr. Reference të Postës Shqiptare: RR753691409AL dhe zarfi i dërguar pranë Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër me Nr. Reference të Postës Shqiptare: RR753691390AL, nga një individ që nuk ekziston në Rregjistrin e Gjendjes Civile të Republikës së Shqipërisë, kanë mbërritur pranë këtyre institucioneve, por pas procedurës hetimore ka qënë i pamundur evidentimi i përmbajtjes së shkresës që ndodhej në to. Edhe pse pala ankuese ka paraqitur pranë KMD-së një kopje të shkresës për të cilën pretendon se ka qënë shkak i diskriminimit, është e pamundur të evidentohet përmbajtja e saj.

Gjithashtu, vlen të theksohet se Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, gjatë procedurave hetimore, ka administruar një kopje të Librit të Protokollit të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve

⁷ Neni 2: “Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminim.”

⁸ Në interpretim të nenin 1, të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, “...ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Shkodër, për datat 15.09.2017-04.12.2017, ku nuk konstatohet që pranë këtij institucioni të jetë protokolluar një shkresë e ardhur nga shtetasi M. H. apo nga organizata e Partisë Socialiste, Rajoni 5, Shkodër.

Pavarësisht se ankuesi i provon bindjet e tij politike me dokumentacionin dhe faktet e administruara pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, nuk provohet fakti që ka patur një trajtim të diferencuar dhe të pabarabartë gjatë procedurave të largimit apo ndërprerjes së delegimit të kompetencave të Drejtorit të Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve, të ankuesit krahasuar me të tjerë, për shkakun e pretenduar. Fakti që ankuesi pretendon se shkakun i bindjeve politike, ka bërë që të trajtohet në mënyrë diskriminuese, nuk është i mbështetur në prova dhe në fakte.

Referuar fakteve dhe provave të sipërcituara, nuk konstatohet të jenë përdorur praktika diskriminuese ndaj E. N., nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër, për shkakun e pretenduar nga ankuesi, pasi nuk rezultoi të ekzistonte një lidhje shkakësore ndërmjet trajtimit të pafavorshëm dhe shkakut të pretenduar.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 1, 3/1, neni 7/1, neni 12/1/a), b), nenin 32, pika 1/a), c), si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të E. N., nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër, për shkak të bindjeve politike.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Bindjet politike)
(Fusha: Punësim)